



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1496/10 prot.

Tiranë më 01.08.2025

VENDIM

Nr. 25, datë 01.08.2025

PËR KONTROLLUESIN “ARKIVI SHTETËROR I SISTEMIT GJYQËSOR”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji nr. 124/2024”), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor” (në vijim, “Kontrolluesi ose Arkivi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 127, datë 11.06.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave I.Gj në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i ngarkuar me ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve arkivore gjyqësore të klasifikuara si RHK (Rëndësi Historike Kombëtare).
2. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit të të dhënave I.Gj administruar me nr.1496 prot., datë 30.05.2025, nëpërmjet së cilës pretendon se, dosja e saj që përmban akte të procesit të rivlerësimit kalimtar i janë vënë në dispozicion një pale të tretë nga ana e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

3. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur, si dhe garantimit të përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, ka nxjerrë Urdhrin nr.127, datë 11.06.2025 për kryerjen e hetimit administrativ pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, me objekt, *“Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave I.Gj, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”*”.

Grupi i inspektimit është paraqitur në datën 18.06.2025 pranë ambienteve të Kontrolluesit, duke bërë me dije qëllimin e hetimit administrativ në lidhje me verifikimin e ankesës.

Kontrolluesit, iu kërkua informacion dhe sqarime në lidhje me pretendimet e ankueses si dhe përpunimin e të dhënave personale për rastin konkret.

Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit, nën cilësinë e provës, të gjithë praktikën e subjektit të të dhënave I.Gj, ku përfshihet korrespondenca shkresore midis institucioneve në lidhje me veprimet e kryera mbi dosjen e saj.

Nga analizimi i provave të administruara nga grupi i hetimit, rezulton se kërkuesja av. A.K. (në vijim, *“kërkuesja A.K”*), më datë 30.01.2025, i është drejtuar me kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim, *“KLGJ”*) të administruar nga ana e tyre me nr. 214/2 prot., datë 03.02.2025 me objekt kërkesë *“vënien në dispozicion të dosjes së plotë të përgatitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që lidhet me rivlerësimin kalimtar të subjektit të të dhënave I.Gj. (dhe personave të lidhur me të), me detyrë Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, vërehet se, kërkuesja A.K, i është drejtuar fillimisht Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, *“KPK”*) lidhur me informacionin e kërkuar, por kërkesa e saj është kthyer nga posta me përgjigjen se, ky institucion ka pushuar së funksionuari ligjërisht që nga data 31.12.2024. Në këto kushte, kërkuesja me qëllim marrjen e informacionit ka dërguar kërkesë në KLGJ.

Referuar kërkesës së bërë nga kërkuesja A.K, KLGJ me shkresën nr. 214/3 prot., datë 05.02.2025, i është drejtuar Arkivit duke i bërë me dije rastin e kësaj kërkesë mbi vënien në dispozicion të dosjes të subjektit të rivlerësimit të subjektit të të dhënave I.Gj dhe ndër të tjera, ka cituar se në përputhje me Kushtetutën, pas përfundimit të mandatit të KPK më datë 31.12.2024, KLGJ merr atributin e vazhdimësisë për administrimin dhe ruajtjen e dosjeve origjinale të subjekteve të rivlerësimit. Megjithatë deri në momentin e kësaj shkrese (05.02.2025) nuk kishte filluar procesi i dorëzimit mes KPK dhe KLGJ.

Në këto kushte, në bazë të nenit 12, të ligjit nr. 115/2024 *“Për buxhetin për vitin 2025”* i cili parashikon se *“Për vitin 2025, për një periudhë jo më shumë se gjashtë*

muaj, për të finalizuar procesin e mbylljes së veprimtarisë administrative të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik, një pjesë e numrit të punonjësve administrativë të këtyre institucioneve sipas vendimit të Kuvendit do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë dhe do të jenë pjesë e programit buxhetor të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë”, KLGJ ja ka përcjellë trajtimin e kësaj kërkesë Arkivit.

Lidhur me përcjelljen e kësaj kërkesë për trajtim tek Arkivi, është vënë në dijeni edhe Ministria e Drejtësisë e cila me shkresën nr. 857/1 prot., datë 13.02.2025 i ka përcjellë Arkivit shkresën e KLGJ, për kompetencë dhe trajtim në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 888, datë 31.12.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”*, dhe ka kërkuar që në përfundim të veprimeve të informohet KLGJ si dhe të vihet në dijeni Ministria e Drejtësisë lidhur me trajtimin e kërkesës.

Nga sa më sipër, në vijim të shkresës me nr. 214/3 prot., datë 05.02.2025 të KLGJ, si dhe në zbatim të ligjit nr. 115/2024 *“Për buxhetin për vitin 2025”*, Vendimit të Kuvendit nr. 110/2024 *“Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”* rezulton të jetë mbajtur një procesverbal me nr. 65/2 prot., datë 17.02.2025, për dorëzimin pranë Arkivit të 5 (pesë) kutive me dokumentacion të fotokopjuar të dosjes së rivlerësimit kalimtar të subjektit të të dhënave I.Gj firmosur nga punonjësit administrativ të KPK (dorëzuesit) drejt punonjësve të Arkivit (marrësit).

Në vijim, me shkresën nr. 65/3 prot., datë 17.02.2025 Arkivi i është drejtuar KLGJ (dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë dhe kërkueses A.K), ku shprehet se *“me qëllim dërgimin tek subjekti kërkuar në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore në fuqi ju dërgojmë dokumentacionin e dosjes së subjektit të të dhënave I.Gj, të fotokopjuar nga punonjësit administrativ të caktuar”. Bashkëlidhur procesverbali i mbajtur me 5 kuti me dokumentacion arkivor të dosjes së subjektit të të dhënave I.Gj.*

Në përgjigje të shkresës së Arkivit, KLGJ nëpërmjet shkresës nr. 214/5 prot., datë 26.02.2025 i ka kthyer përgjigje ku sqaron se dërgimi i shkresës për trajtim nga ana e KLGJ drejt Arkivit është bazuar në nenin 24, pika 1, Kodi Procedurave Administrative *“1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuarin për këtë. Ndërkohë, në përputhje me nenin 19, pika 5, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, KLGJ gjatë kësaj periudhe kalimtare nuk disponon dosjet e subjekteve të rivlerësimit, pasi procesi i dorëzimit KPK-KLGJ nuk ka filluar. Gjithashtu, KLGJ ka cituar se dokumentacioni arkivor përkatës mungon bashkëlidhur shkresës që ka dërguar Arkivi.*

Nëpërmjet shkresës nr. 857/4 prot., datë 10.03.2025 Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë Arkivit shkresën e sipërcituar të KLGJ duke kërkuar nga Arkivi verifikimin dhe vlerësimin e fakteve të parashtruara dhe marrjen e masave për zgjidhjen e rastit duke venë në dijeni dhe Ministrinë.

Në vijim të korrespondencave shkresore, rezulton se nëpërmjet shkresës nr.65/6 prot., datë 11.03.2025, Arkivi i ka kthyer përgjigje KLGJ, ku e ka informuar dhe sqaruar se *“dokumentacioni i dosjes së subjektit të të dhënave I.Gj ju është dërguar dorazi me korrier në datë 18.02.2025, por punonjësi juaj i zyrës së sekretari-arkivit nuk e mori në dorëzim me justifikimin se i duhej dorëzuar subjektit kërkues, korrieri u instruktua t’ia vinte në dispozicion dokumentacionin kërkueses A.K në adresën e përcaktuar në shkresën tuaj. Bashkëlidhur konfirmimi i veprimeve lidhur me dorëzimin dhe pranimin e dokumentacionit deri tek subjekti kërkues”*.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton të jetë pjesë e praktikës dhe ankesa e subjektit të të dhënave drejtuar Arkivit me objekt *“shkelje e ligjit nga punonjësit e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor lidhur me dorëzimin e dokumentacionit të përmbajtur në dosjen time të vlerësimit në mënyrë të paanonimizuar në kundërshtim me ligjin për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Në kuadër të kthim përgjigjes për subjektin e të dhënave I.Gj, drejtuesi i komanduar i Arkivit duke mos pasur dijeni mbi këtë rast, pasi nuk ka qenë në detyrë në kohën e trajtimit të kërkesës, ka komunikuar më datë 12.06.2025 nëpërmjet email-it me dy punonjës të KPK, ku i ka dërguar ankesën e subjektit të të dhënave I.Gj dhe i ka kërkuar çdo informacion që disponojnë në lidhje me dokumentacionin e dosjes së saj.

Në përgjigje të këtij email-i, ka pasur dy përgjigje nga adresat zyrtare të KPK, ku në njërin prej tyre është informuar se, *“theksojmë se nuk kemi asnjë dijeni mbi trajtimin e kërkesës së kërkueses A.K nga drejtuesi i Arkivit dhe koordinatori. Madje as për përgjigjen që kanë dhënë për këtë rast, as për mënyrën se si ky Arkiv e ka shërbyer te subjekti kërkues dosjen e subjektit të të dhënave I.Gj”*.

Gjithashtu, është informuar se, *drejtuesi i Arkivit dhe koordinatori, kanë kërkuar vetëm fotokopje, punë e cila është bërë nga punonjëset tona të arkivës dhe është dorëzuar në procesverbal të hartuar në arkiv*.

Ndërsa në emailin tjetër është sqaruar se: *Drejtuesi i Arkivit dhe koordinatori, hartonin shkresa ku flitej për KPK, procesin e dorëzimit të dosjeve, etj., dhe komunikonin me institucionet pa dijeninë tonë. Në lidhje me problemin e subjektit të të dhënave I.Gj mund të shikoni në protokollin tuaj një shkresë me nr. 214/3 prot., datë 05.02.2025 dhe me këtë shkresë jemi njohur nëpërmjet email-it të drejtuesit të Arkivit të datës 11.02.2025, ku kërkonte fotokopjen e dosjes në fjalë për të vepruar më tej sipas mënyrës së tij*.

Për të vijuar me hetimin administrativ, grupi i inspektimit ka kërkuar nga Kontrolluesi si provë komunikimin me email të drejtuesit të Arkivit me punonjësit e KPK, në lidhje me mënyrën e sigurimit të informacionit për dosjen gjyqësore të subjektit të të dhënave I.Gj.

Në lidhje me këtë kërkesë, Kontrolluesi deklaroi fillimisht se, në email-et e drejtuesit të Arkivit nuk mund të ndërhyjnë pasi ai është ende në detyrë, por rezulton me raport mjekësor për një afat të pacaktuar, Gjithashtu, Arkivi nuk disponon punonjës IT për të kryer kërkime të tilla në sistemet e Arkivit.

4. Nga verifikimi i korrespondencave shkresore dhe provave të administruara, rezulton se, kërkesja A.K ka marrë dokumentacionin e dosjeve në datën 18.02.2025, fakt i cili evidentohet qartë nga shënimi i saj në kopjen e procesverbalit ku shkruhet se *“Mora në dorëzim 5 (pesë) dosje nga Arkivi i Sistemit Gjyqësor, më datë 18.02.2025”*, e firmosur dhe vulosur prej saj.

Ndërkohë, pretendimi i Kontrolluesit se dokumentacioni i dosjeve është dorëzuar pranë KLGJ, dorazi nëpërmjet korrierit më datë 18.02.2025 (pas refuzimit të KLGJ, i është dorëzuar drejtpërdrejtë kërkueses A.K në po të njëjtën datë), përbën mospërputhje me librin e dorëzimit të postës në të cilën rezulton se dokumentacioni ka dalë nga Arkivi një datë më vonë, konkretisht më datën 19.02.2025, fakt i cili konfirmohet edhe nga vula postare.

Fakti i mësipërm përbën një mospërputhje të dukshme dhe rrjedhimisht e bën të pabazuar pretendimin e Kontrolluesit për sa kohë dërgesa e këtij dokumentacioni rezulton në data të ndryshme nga provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, korrespondencës zyrtare si dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se Arkivi ka marrë në dorëzim dokumentacionin e fotokopjuar të dosjes së rivlerësimit kalimtar të subjektit të të dhënave I.Gj. Ky veprim është mbështetur me kërkesën e KLGJ, në kuadër të periudhës kalimtare pas mbylljes së mandatit të KPK.

Referuar dispozitave të posaçme ligjore si dhe analizës së kompetencave ndërinstitutionale të përcaktuara pas përfundimit të mandatit të KPK-së, rezulton se përgjegjësia dhe atributet e vazhdimësisë për administrimin dhe ruajtjen e dosjeve origjinale të rivlerësimit kalimtar për magjistratët gjyqtarë i është deleguar KLGJ. Sipas evidentimit në shkresën nr. 214/3 prot., datë 05.02.2025, administruar në dosje, KLGJ pritet të marrë në dorëzim serinë 9-001, që përfshijnë vendimet për konfirmim në detyrë të subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

Zyra e Komisionerit thekson se, në pikën 2, të nenit 2 të LDI, parashikohet se: *“informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe*

formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, autoriteti publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar. Megjithatë, në nenin 17 të LDI, parashikohet mundësia e kufizimit të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë autoritetin publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këtë kuptim është autoriteti publik, në këtë rast Arkivi i cili duhet të bënte vlerësimin nëse dokumentacioni/informacioni i kërkuar, i nënshtrohet apo jo kufizimeve të këtij ligji duke ju referuar gjithashtu edhe legjislacionit specifik.

Autoriteti publik duhet të mbante parasysh parashikimin në pikën 6 të nenit 17 të LDI, i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentit përkatës që janë refuzuar dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.”*, bazuar në këtë parashikim ai duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarës vetëm pjesën tjetër të tij.

Ndërsa, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 124/2024, konstatohet se, Arkivi në cilësinë e Kontrolluesit ka përhapur të dhënat e subjektit të të dhënave I.Gj në kundërshtim me parimet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale si dhe masat për të garantuar sigurinë e përpunimit, të parashikuara në nenet 6, 7 dhe 28 të ligjit nr. 124/2024.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, në çdo rast, duhet të kryhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sanksionuar në nenin 6 të ligjit nr. 124/2024, i cili ndër të tjera, parashikon se mbrojtja e të dhënave personale bazohet në parimet e *“... përpunimit në përputhje me qëllimin, që nënkupton se të dhënat personale mbledhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër, që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar”* dhe *“... minimizimit të të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale janë të përshtatshme e të nevojshme për qëllimin e përpunimit dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit”* (pikat 2 dhe 3 të nenit 6 të ligjit nr.124/2024).

Përhapja e të dhënave personale është një nga format e përpunimit të të dhënave, e parashikuar në pikën 16, të nenit 5 të ligjit nr.124/2024 dhe si e tillë, realizimi i saj duhet analizuar nga kontrolluesi, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 7 të ligjit nr.124/2024. Sipas këtij neni të dhënat personale përpunohen ndër të tjera vetëm *“c) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit”*.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është përgjegjësi e Kontrolluesit për të verifikuar nëse masat për sigurinë e të dhënave personale janë përmbushur, siç parashikohet në pikën 1 dhe 2 të nenit 28 të ligjit nr.124/2024: *“...kontrolluesi dhe*

përpunuesi zbatonë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke marrë parasysh veçanërisht rreziqet që shkaktohen nga përpunimi, specifikisht, nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, përhapja e paautorizuar ose aksesit në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në çfarëdolloj mënyre”.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi, është paraqitur në seancën dëgjimore datë 10.07.2025, dhe ka depozituar pretendimet me shkrim me shkresën nr. 290/3 prot., datë 07.07.2025, administruar me tonën nr. 1496/7 prot., datë 09.07.2025 si dhe dokumentacion plotësues (korrespondencë me email ndërmjet Kontrolluesit dhe KPK) mbi konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ.

Në përmbajtjen e këtyre email-eve, ndër të tjera Kontrolluesi shpreh se, *“ai nuk ka kërkuar fotokopje dokumentacioni për nevojat e veta. Ka qenë detyrim ligjor i sekretarit të përgjithshëm të KPK leximi dhe kuptimi i shkresës së skanuar të KLGJ si dhe përgatitja e fotokopjes së dokumentacionit në përputhje me legjislacionin përkatës”.*

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Kontrolluesi parashtroi verbalisht të njëjtat argumente ku ndër të tjera ka sqaruar edhe një herë vazhdimësinë e veprimeve që kanë ndodhur lidhur me rastin, dhe konkretisht se *“...Më datë 17.02.2025, është hartuar një procesverbal për dorëzimin e 5 kutive me dokumentacionin e fotokopjuar të dosjes së subjektit të të dhënave I.Gj nga punonjësit e KPK, tek punonjësit e Arkivit. Me shkresën e datës 17.02.2025, Arkivi ka dërguar një shkresë në KLGJ në kuadër të trajtimit të kërkesës së deleguar, duke bërë me dije se dokumentacioni i fotokopjuar po dorëzohej me qëllim dërgimin e saj tek kërkuuesja A.K. Në refuzim të marrjes së dokumentacionit nga KLGJ, i është dorëzuar dorazi vetë kërkueses A.K.*

Lidhur me pretendimet e Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e Kontrolluesit marrja e masave për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 124/2024, duke mundësuar shmangien e pasojave që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germës “a”, të pikës 1, të nenit 94 të ligjit nr.124/2024, si dhe germës “a” të pikës 2 të nenit 94 të ligjit nr.124/2024, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

“1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:

a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;

2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:

a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;”.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri është bazuar në Udhëzimin nr. 06, datë 16.07.2025 për “Miratimin e metodologjisë për përlllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”, pikat 7 dhe 8, të sesionit 2.3 të Kapitullit 2. Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze.

Kontrolluesi ka cenuar drejtpërdrejt parimet themelore të përpunimit të të dhënave personale, përfshirë ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe integritetin e përpunimit, të cilat mbrojnë interesin thelbësor të të dhënave personale të individit. Konkretisht, vendosja në dispozicion e të dhënave personale të përfshira në dosjen e rivlerësimit të një subjekti të dhënash, në mënyrë të paanonimizuar, pa respektuar parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe minimizimit të të dhënave, përbën një përpunim të paligjshëm të të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 28, 81, 82, 83, 84, 93, pika 1, germa “a” dhe pika 2, germa “a” të nenit 94, si dhe nenin 95 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i. në vijimësi, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër;
 - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 5 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
8. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 01.08.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi